



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2943/2 prot.,

Datë 24.11.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-78188-08-23-2023, me objekt: “*Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin*” me fond limit 7,639,413 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kurbin.

Ankimues: “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, me NUIS K81314023A, me adresë: Rruga e Durrësit, Hyrja Nr.3, Pasuri e Llojit Njesi Nr.4/12+3-B/1, Zona Kadastrale 8210, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kurbin me adresë: Lagjia Nr.3, Laç

Në datën 23.11.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2943/2023 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3644 e operatorit ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-78188-08-23-2023, me objekt: “*Lyerje dhe meremetime të Shkollave (dhe mirëmbajtje elektrike dhe hidraulike), Bashkia Kurbin*” me fond limit 7,639,413 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kurbin.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2943 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon: KVO pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, konstatoi se operatori ekonomik nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DST, si më poshtë: • KVO konstatoi se operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, nuk plotëson pikën 2.3.8 të kriterëve të veçanta të DST-së, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kriterëve të përcaktuara në DST për mjetet (Automjet transporti 3-5 ton 2 copë & mjetet Kamioçina 2 copë). Së pari: Sqarojmë se OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka deklaruar se disponom me qira (Automjet transporti 3-5 ton, mjetet me targa AB483BD & AB926 JU). Por KVO verifikoi dokumentacionin që OE ka paraqitur për këto mjete (dokumentacion i cili është i njësuar me origjinalin me Nr.5413 Rep, date 20.10.2023) dhe konstatoi se për dy automjetet e transportit me targa AB483BD & AB926 JU, nuk ka paraqitur fare Taksat Vjetore, kriter ky i përcaktuar nga AK në DST. Së dyti: Gjithashtu sqarojmë se OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka deklaruar se disponom me qira (Kamioçinat me targa TR5568R, AA782CG, AA176YD, AB632JD). Por KVO verifikoi dokumentacionin që OE ka paraqitur për këto mjete (dokumentacion i cili është i njësuar me origjinalin me Nr.5413 Rep, date 20.10.2023 si dhe me Nr.5365 Rep, date 20.10.2023) dhe konstatoi se dy mjetet me targë AA782CG & AB632JD i plotësojnë kriteret e përcaktuara në DST, pasi për këto dy mjete ka paraqitur dokumentacion e plotë, ndërsa për Kamioçinat me targë TR5568R & AA176YD nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kriterëve të përcaktuara nga AK në DST. Sqarojmë se për Kamioçinën me targë TR5568R, përveç kontratës së qirasë Nr.46 Prot, date 01.09.2023, nuk ka paraqitur fare dokumentacion

tjetër, ndërsa për kamioçinën me targë AA176YD, nuk ka paraqitur fare Taksat Vjetore, kriter ky i përcaktuar nga AK në DST. Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe të nenit 82, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK, S’Kualifikohet..”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 24.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri